

 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren <b>"UKSHIN HOTI"</b>	
Pranuar me dt.	30.12.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-486



**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN**  
**UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

Ruga e Shkronjave Nr. 1, 20000  
 Prizren, Republika e Kosovës.  
 Tel: +381 (0) 29- 232 140;  
 Homepage: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

**RREGULLORE PËR KËRKIME SHKENCORE**

Prizren, Dhjetor 2019



Në bazë të dispozitave ligjore të nenit 42 dhe 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, i Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" (tutje referuar si Universiteti ), Senati i këtij Universiteti në mbledhjen e mbajtur më: 27.12.2019 miratoi:

## **Rregulloren për kërkime shkencore**

### **Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1.**

Me këtë Rregullore organizohet puna dhe aktivitetet kërkimoro-shkencore, të drejtat dhe detyrimet e organeve kompetente të Universitetit dhe pjesëmarrësve në aktivitete kërkimoro-shkencore, veprimtari botuese, pjesëmarrje në kongrese e konferenca shkencore, seminare dhe simpoziume, si pjesë e veprimtarisë kërkimoro-shkencore e Universitetit.

### **Organizimi i veprimtarisë kërkimoro-shkencore**

#### **Neni 2.**

Stafi akademik i Universitetit është i obliguar të bëjë kërkime shkencore dhe punë hulumtuese në përputhje me aftësitë e tyre profesionale dhe obligimet që dalin nga Plani Strategjik i Universitetit dhe, nga Këshillat e Njësive Akademike. Çdo anëtar i stafit akademik, do të vlerësohet një herë në vit për kontributin e tij në veprimtarinë kërkimoro-shkencore.

#### **Neni 3.**

Universiteti përkushtohet për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe përkrahjen e punës kërkimoro-shkencore gjithashtu për të ndihmuar stafin akademik që të arrijë rezultate konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

#### **Neni 4.**

Veprimtaria kërkimoro-shkencore përfshin këto aktivitete:

4.1. Realizimin e hulumtimeve themelore, të avancuara dhe aplikative me qëllim të zhvillimit të hulumtimit shkencor në fushat si: shkencat ekonomike, shkencat juridike, shkencat kompjuterike, shkencat e jetës dhe mjedisit, edukimi prashkollor dhe fillor, gjuha dhe letërsia, si dhe fushat tjera nga lëmia socio-ekonomike dhe shkencat e teknologjisë informatike;



- 4.2. Realizimin e hulumtimeve në ndërmarrjet private me qëllim identifikimin e nevojave të tyre për profile specifike të kuadrove;
- 4.3. Organizimin e konferencave shkencore, vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, të punëtorive dhe seminareve;
- 4.4. Zhvillimin e hulumtimit shkencor dhe bashkëpunimin me institucionet tjera hulumtuese në vend dhe jashtë vendit;
- 4.5. Bashkëpunimin me ndërmarrjet ekonomike dhe industriale;
- 4.6. Përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe analizave të ndryshme biznesore për bizneset private dhe ndërmarrjet publike,
- 4.7. Ekspertiza dhe superekspertiza të çështjeve ekonomike dhe ato të gjyqësorit;
- 4.8. “Raporte Legal Due Diligence”, për korporatat multinacionale;
- 4.9. Përpilimin e programeve investuese dhe programeve të tjera;
- 4.10. Organizimin e seminareve për zhvillimin profesional të stafit akademik në lëmitë shkencore të Universitetin;
- 4.11. Edukimin e vazhdueshëm profesional (EVP-ë, dhe CPD-ë), për stafin akademik, njëzetë orë obligative të verifikueshme;
- 4.12. Veprimtarinë botuese, (botimin e librave, teksteve universitare, monografive dhe punimeve shkencore);
- 4.13. Veprimtaritë tjera hulumtuese e shkencore në fushat që mbulohen me programet studimore në Universitet.

### **Themelimi dhe funksionimi i instituteve kërkimoro-shkencore**

#### **Neni 5.**

Institutet kërkimoro-shkencore në kuadër të Universitetit janë:

- 5.1. Qendra për inovacione dhe punësim (Erasmus+);
- 5.2. Institutet kërkimoro-shkencore të njësisë akademike.

#### **Neni 6.**

Veprimtaria e instituteve kërkimoro-shkencore realizohet në formë të kërkimeve themelore dhe kërkimeve të aplikuara në përputhje me nevojat e komunitetit biznesor dhe atij industrial, e që janë në interes të komunitetit.

#### **Neni 7.**



Në përputhje me Strategjinë për Kërkime Shkencore të Universitetit, institutet kërkimoro-shkencore janë përgjegjës për:

- 7.1. Udhëheqjen e aktiviteteve të hulumtimit nëpër njësi akademike apo në nivel të Universitetit, në pajtim me misionin dhe planin strategjik;
- 7.2. Hartimin e planit vjetor të njësisë akademike, universitare për punë kërkimoro-shkencore së bashku me buxhetin vjetor që ka të bëjë hulumtim shkencor;
- 7.3. Hartimin e politikës për kompensimin e pjesëmarrësve në realizimin e veprimtarisë hulumtuese;
- 7.4. Përpilimin e politikave, rregulloreve dhe procedurave për rregullimin e veprimtarisë hulumtuese;
- 7.5. Ndjekjen e pagesave rreth kompensimeve për punët e realizuara, shërbimeve për të dhëna, furnizimit me materiale dhe mjete pune për koordinatorët e projekteve;
- 7.6. Organizimin e sistemit të evidentimit dhe ruajtjes së të gjithë dokumentacionit që ndërlidhet me aktivitetin e instituteve kërkimore në një periudhë dhjetë vjeçare;
- 7.7. T'i evidentojë në mënyrë kronologjike dukomentet që i dedikohen institutit në një sistem të integruar dhe të dizajnuar enkas për nevoja të Institutit;
- 7.8. Të mbaj të azhurnuara regjistrat për evidentimin e pasurisë në emër të Institutit dhe të bëjë një herë në vit inventarizimin e pasurisë;
- 7.9. Të kryej raportimin vjetor në Këshillin e Njësisë Akademike, dhe në Senatin e Universitetit rreth aktiviteteve hulumtuese e financiare të Institutit;

#### **Neni 8.**

Forma e organizimit dhe funksionalizimit të instituteve kërkimoro-shkencore të njësisë akademike definohet me Rregullore të veçantë.

#### **Themelimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Shkencor**

#### **Neni 9.**

- 9.1. Me vendim të Senatit, themelohet Këshilli Shkencor i Universitetit, me këtë përbërje:
  - a) Prorektori për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Kërkime Shkencore;
  - b) Nga një anëtarë përfaqësues i secilës njësi akademike, staf akademik me përvojë të dëshmuar në punën kërkimoro-shkencore, i propozuar nga Këshilli i Fakultetit;
  - c) Një përfaqësues i studentëve, i propozuar nga Parlamenti i Studentëve, dhe
  - d) Një këshilltar i jashtëm, i propozuar nga Bordi Këshilldhënës Industrial.



- 9.2. Këshilli Shkencor verifikon dhe vlerëson përputhshmërinë e të arriturave kërkimoro-shkencore të stafit akademik në bazën e të dhënave për punën kërkimoro-shkencore, dhe në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren për zgjedhje dhe avancim akademik.
- 9.3. Puna dhe funksionimi i Këshilli Shkencor rregullohet me udhëzimet dhe procedurën operacionale.
- 9.4. Puna e Këshillit Shkencor përfshinë alokimin e pikëve për vlerësimin dhe promovimin e stafit akademik në përputhje me Rregulloren për zgjedhje dhe avancim akademik.

### **Politikat dhe masat nxitëse për punën kërkimoro-shkencore**

#### **Neni 10.**

Në funksion të ndërtimit të politikave nxitëse që synojnë rritjen e konkurrentshmërisë, vizibilitetit dhe avancimit në rangimin ndërkombëtar të Universitetit, parashihet shpërblimi për personelin akademik i cili publikon punime shkencore. Nxitja e punës kërkimoro-shkencore përfshinë zbatimin e masave nxitëse, të specifikuara si në vijim:

10.1. Personeli i rregullt akademik i Universitetit i cili publikon punime shkencore në revistat shkencore të indeksuara në platformën Web of Science (WoS), shpërblehet nga buxheti i Universitetit me një vlerë monetare njëherëshe prej 1,200 Euro (një mijë e dyqind euro) dhe në platformën Scopus shpërblehet me një vlerë monetare prej 700 Euro (shtatëqind euro).

10.1.1. Në rastet kur një punim shkencor (ashtu si parashihet në pikën 10.1.), punohet nga dy ose më shumë autorë që janë anëtarë të stafit akademik të Universitetit, atëherë 70% e shpërblimit monetar i paguhet autorit të parë të punimit shkencor, ndërsa 30% e vlerës monetare shpërndahet në mënyrë të barabartë për bashkëautorët tjerë.

10.1.2. Bashkëautorët e punimit shkencor (ashtu si parashihet në pikën 10.1.), nga Universitet tjera brenda dhe jashtë vendit nuk mund të përfitojnë shpërblime monetare.

10.1.3. Raportin e verifikimit dhe kontrollit të vërtetësisë që punimi shkencor i përmbushë kushtet e parapara në pikën 10.1. e bënë Këshilli Shkencor, në bazë të kërkesës së shkruar të autorit apo bashkëautorëve të punimit shkencor.

10.1.4. Pas hartimit të raportit të Këshillit Shkencor, të paraparë sipas pikës 10.1.3, të kësaj rregulloreje, i njejti raport duhet të dorëzohet në Këshillin Drejtues të Universitetit për shqyrtim dhe miratim.

10.1.5. Ekzekutimin e vendimit të Këshillit Drejtues sipas pikës 10.1.4. e bënë Prorektori për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë dhe Zyra e Financave të Universitetit.

10.2. Pjesëmarrja dhe prezantimi i punimeve shkencoro-kërkimore të personelit akademik të Universitetit, në kongrese e konferenca, me miratim të Këshillit të Njesisë Akadematike, përkrahet nga buxheti i Universitetit, me mbulimin e plotë të shpenzimeve të pjesëmarrjes, respektivisht pagesën e taksës së pjesëmarrjes, akomodimit, shpenzimeve të transportit dhe mëditjeve.

10.3. Me qëllim të zbatimit të politikave të Edukimit e Vazhdueshëm Professional (EVP), për stafin akademik të Universitetit, me miratim të Këshillit të Njesisë Akadematike, përkrahet nga buxheti i Universitetit, me mbulimin e plotë të shpenzimeve, si: pjesëmarrja në punëtori (workshope), seminare, konferenca, kongrese, dhe organizime të tjera që kontribuojnë në ngritjen dhe zhvillimin e EVP-së.

10.4. Masat nxitëse për botime të librave universitare dhe monografive, rregullohen sipas Rregullores për Shtëpi Botuese.

### **Masat ndëshkuese për pasivitet në punën kërkimoro-shkencore**

#### **Neni 11.**

11.1. Pasiviteti i stafi akademik në aktivitetet kërkimoro-shkencore mund të ndëshkohet në formë të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dekani i njesisë akademike mund të ndërmarrë këto masa:

- a) Shqiptimin e vërejtjes verbale;
- b) Shqiptimin e vërejtjes me shkrim;
- c) Ngarkimin me detyra shtesë sipas nevojave të njesisë akademike; dhe
- d) Masat e tjera të parapara me legjislacionin në fuqi.

### **Organizimi dhe bashkëorganizimi i konferencave kërkimoro-shkencore**

#### **Neni 12.**

12.1. Stafi akademik i Universitetit, inkurajohet të organizoj, bashkëorganizoj konferenca, kongrese, punëtori apo seminare me karakter kërkimoro-shkencor. Për këtë qëllim,



Universiteti do të mbështes organizimin e këtyre aktiviteteve kërkimoro-shkencore, qoftë duke ofruar infrastrukturën e tij brenda Kampusit të Universitetit apo përkrahjen e nevojshme financiare për mbarëvajtjen e këtyre aktiviteteve.

12.2. Përfaqësuesit e studentëve me përkrahjen e menaxhmentit dhe stafit akademik të Universitetit do të organizojnë Konferencën Shkencore Studentore. Kjo konferencë organizohet çdo vit në periudhën Maj-Qershor dhe se e njëjta do të organizohet në nivel të çdo njësie akademike. Për mbarëvajtjen e kësaj konference, Universiteti do t'i ofroj studentëve infrastrukturën dhe përkrahjen e nevojshme brenda kampusit të Universitetit, si dhe do të ndaj buxhetin e nevojshëm për organizimin e saj.

### **Planifikimi financiar i përmbushjes objektive të punës kërkimoro-shkencore**

#### **Neni 13.**

Obligohet Prorektori për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë, që të planifikoj ndarjet buxhetore vjetore dhe ato të kornizës afatmesme të planifikimit financiar të Universitetit, me qëllim të përmbushjes së obligimeve të kësaj rregulloreje.

### **Hartimi i raportit vjetor të punës kërkimoro-shkencore**

#### **Neni 14.**

14.1. Zyra e Prorektorit për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe për Kërkime Shkencore harton dhe publikon raportin vjetor të punës kërkimoro-shkencore në Universitet. Ky raport duhet të përmbledh punimet shkencoro-kërkimore dhe aktivitetet tjera shkencore të njësisë akademike dhe stafit akademik të rregullt të Universitetit.

14.2. Obligohen njësitë akademike që të hartojnë planet vjetore të detajuara për punën kërkimoro-shkencore si dhe planin buxhetor për realizimin e tyre. Njësitë akademike obligohen që të hartojnë një raport mbi punimet shkencoro-kërkimore dhe aktivitetet tjera shkencore të njësisë akademike.

### **Hyrja në fuqi, ndryshimi dhe zbatimi**

#### **Neni 15.**


15.1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati i Universitetit.

15.2. Gjithashtu kjo rregullore mund të plotësohet dhe të ndryshohet me kërkesën e Rektorit dhe miratimin nga ana e Senatit të Universitetit.



---

**Kryesues i Senatit të Universitetit**

  
**Prof. Asoc. Dr. Ismet Tema**

